

Sipas autoritetit të dhënë nga Neni 28 dhe 58.5 të Ligjit mbi Rregullatorin e Energjisë, Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në seancën e mbajtur me 24 Shkurt 2006 miratoi:

RREGULLIN PËR LIÇENCIMIN E AKTIVITETEVE TË ENERGISË NË KOSOVË

KAPITULLI 1

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi dhe Fushëveprimi

- 1.1 Synimi i përgjithshëm i këtij Rregulli është që të krijojë një procedurë publike, transparente dhe jo-diskriminuese për liçencim, e cila promovon themelimin dhe funksionimin e tregut të energjisë në baza të konkurrencës duke stimuluar investimet dhe duke ofruar siguri dhe stabilitet të sektorit të energjisë në Kosovë.
- 1.2 Qëllimi i këtij Rregulli është që të përkrahë zhvillimin e sektorit të energjisë përmes:
 - a) kryerjes transparente, të hapur dhe jo-diskriminuese të aktiviteteve të energjisë;
 - b) rregullimit të tregut të energjisë në atë mënyrë që të sigurojë marrëdhënie të paanshme dhe transparente ndërmjet gjithë pjesëmarrësve;
 - c) përcaktimit dhe përgatitjes në mënyrë sa më të shpejtë, efikase dhe ekonomike të procedurave mbi çështjet lidhur me lëshimin e liçencave;
 - d) krijimit dhe mirëmbajtjes së tregut konkurrues, dhe parandalimin dhe dënimin e çdo sjelljeje abuzive apo anti- konkurruese;
 - e) krijimit të kushteve për shfrytëzimin efikas, me kosto efektive, dhe të sigurt të energjisë elektrike dhe ngrohjes;
 - f) balancimit në mënyrë të drejt të interesave midis konsumatorëve dhe ndërmarrjeve për energji;
 - g) mbrojtjes të shëndetit të njerëzve, sigurisë dhe ambientit.
- 1.3 Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) duke zhvilluar të drejtat, obligimet dhe kushtet të liçencës obligon dhe stimulon ndërmarrjet për energji që të veprojnë në mënyrë të domosdoshme që të arrijnë të gjitha objektivat siç përshkruhen në Liçencë.

1.4 Për ti plotësuar obligimet e caktuara në Nenin 1.2, ZRRE-ja ka autoritet për të:

- a) dhënë, ndryshuar, pezulluar, transferuar dhe për të tërhequr liçencat;
- b) mbikëqyrur dhe kontrolluar përputhshmërinë me liçencën;
- c) dhënë leje për ndërtimin dhe operimin e kapaciteteve të reja prodhuese, siç përcaktohet në Kapitullin 8 të Ligjit mbi Rregullatorin e Energjisë;
- d) monitoruar shthurjen e formës ligjore, organizative, vendimmarrëse dhe të llogarive të ndërmarrjeve për energji;
- e) rishikuar, miratuar dhe kontrolluar përputhshmërinë me të gjitha kodet duke përfshirë kodin e rrjetit, kodin e shpërndarjes, kodin e mbrojtjes së konsumatorëve, kodin e pajisjeve elektrike, kodin e standardeve elektrike, kodin e matjes, dhe kodet tjera teknike dhe komerciale;
- f) dhënë pëlqimin për ndarjen, shkrirjen ose zvogëlimin e kapitalit fillestar të ndërmarrjeve për energji që kanë liçenca.

1.5 Rregulli gjithashtu vendos kriteret e përgjithshme që kanë të bëjnë me lëshimin e lejeve për ndërtimin e stabilimenteve të reja për energji sipas nenit 38.1 të Ligjit mbi Rregullatorin e Energjisë. Rregulli i veçantë për Autorizimin dhe legjislacioni i aplikueshëm për tenderim do të vendosin kriteret e detajuara sipas të cilave ZRRE-ja jep lejet për ndërtim.

Neni 2 **Përkufizimet**

2.1 Shprehjet e përdorura në këtë Rregull, do të kenë kuptimin si në vijim:

- a) **“Procedura e Autorizimit”**- nënkupton procedurën e përcaktuar në përputhje me Kapitullin 8 të Ligjit mbi Rregullatorin e Energjisë dhe Rregullit për Autorizim, sipas të cilit ZRRE-ja lëshon leje për ndërtimin e kapaciteteve të reja prodhuese.
- b) **“Leja e Ndërtimit”** - nënkupton autorizimin e dhënë nga ZRRE-ja që lejon mbajtësin e saj të ndërtojë stabilimente të reja për energji, siç përcaktohet në Kapitullin 8 të Ligjit mbi Rregullatorin e Energjisë dhe Rregullin për Autorizimin dhe legjislacionin e aplikueshëm për tenderim.
- c) **„Energjia“** do të thotë çdo formë e prodhuar ose e fituar e energjisë (energji elektrike, ngrohja) me qëllim të furnizimit ose shitjes;
- d) **“Stabilimentet për Energji”** - nënkupton tërësi ndërtesash, instalimesh dhe pajisjesh të vendosura me qëllim të prodhimit të energjisë elektrike dhe ngrohjes apo bashkëprodhimit të energjisë elektrike dhe ngrohjes në formë bashkëprodhimi.
- e) **“Liçencë”** - nënkupton autorizimin e dhënë nga ZRRE-ja që lejon mbajtësit e saj që të ushtrojnë një veprimtari në sektorin e energjisë.

- 2.2 Shprehjet e përdorura në këtë Rregull do të kenë të njëjtin kuptim si shprehjet e përdorura në Ligjin mbi Energjinë, Ligjin mbi Energjinë Elektrike, Ligjin mbi Rregullatorin e Energjisë, Ligjin mbi Ngrohjen Qendrore si dhe ligjet dhe rregulloret e tjera të aplikueshme në Kosovë.

Neni 3

Detyrimet e të Liçencuarve dhe Mbajtësve të Lejes

- 3.1 Asnjë person fizik apo juridik nuk mund të ushtrojë aktivitete për energji për të cilën kërkohet liçenca, në përputhje me Nenin 3.2, përveç nëse ZRRE-ja ka lëshuar liçencën që të lejon aktivitetin e tillë.
- 3.2. Liçenca kërkohet për kryerjen e këtyre aktiviteteve të energjisë:
- a) prodhimin e energjisë elektrike, ose bashkëprodhimin e energjisë elektrike dhe ngrohjes,
 - b) prodhimin e ngrohjes;
 - c) operimin e sistemit të transmetimit të energjisë elektrike;
 - d) operimin e tregut;
 - e) operimin e sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike ose ngrohjes;
 - f) furnizimi publik me energji elektrike dhe ngrohje;
 - g) furnizimin/tregtinë me energji elektrike dhe ngrohje;
 - h) transmetimi ndërkufitar (import, eksport, transit) të energjisë elektrike.
- 3.3 Liçenca nuk kërkohet për aktivitetet e energjisë sipas Nenit 43 të këtij Rregulli.
- 3.4 Të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me gazin natyror si dhe me ndërtimin e gypave të gazsjellësit dhe depozitimit të tij, nuk janë të mbuluara me këtë Rregull.
- 3.5 Liçenca për aktivitete të energjisë që kryhen nga ndërmarrjet për energji, apo lejet për ndërtim të lëshuara nga ZRRE-ja, do të bazohen në kriteret që janë jo-diskriminuese, publike dhe transparente.

KAPITULLI 2

RREGULLAT PROCEDURALE NË LIDHJE ME APLIKIMET PËR LIÇENCA DHE LEJE NDËRTIMI, SI DHE SHQYRTIMI I TYRE NGA ZRRE-ja

Neni 4

Autoriteti i ZRRE-së

- 4.1 ZRRE-ja ka autoritet që të japë leje ndërtimi ose të refuzojë aplikacionin për liçencë ose leje ndërtimi, dhe të modifikojë, japë fund ose të nxjerrë sanksione ndaj të liçencuarve ekzistues dhe bartësve të lejeve të ndërtimit, sipas dispozitave të vendosura në këtë

Rregull, Ligjin mbi Energjinë Elektrike, Ligjin mbi Rregullatorin e Energjisë, rregullat e tjera të nxjerra nga ZRRE-ja dhe legjislacionit të aplikueshëm në Kosovë.

- 4.2. Liçencat dhe lejet e ndërtimit përcaktojnë autoritetin e ZRRE-së për të monitoruar dhe për të kërkuar raportimin nga të liçencuarit apo bartësit e lejeve të ndërtimit në lidhje me aktivitetet e tyre.
- 4.3. Dhënia e ndonjë informate false ose mashtruese, do të jetë bazë për refuzim të aplikimit, ose, nëse zbulohet pas lëshimit të liçencës ose lejes të ndërtimit, do të jetë bazë për tërheqje të liçencës, ose vendosjen e ndonjë sanksioni tjetër nga ZRRE-ja.

Neni 5 Forma e Liçencës dhe Aplikimit për Leje Ndërtimi

Të gjitha aplikimet për liçenca dhe leje për ndërtimin e stabilimenteve të reja për energji, duhet të jenë:

- a) të dorëzuara në formën e përcaktuar nga ZRRE-ja.
- b) të paraqitura në ZRRE në kopje të printuar dhe elektronike, siç është kërkuar nga ZRRE-ja;
- c) në një nga gjuhët zyrtare të Kosovës.

Neni 6 Shqyrtimi i Aplikacioneve

- 6.1. ZRRE-ja do të shqyrtojë aplikacionin për liçencë dhe për leje të ndërtimit me të gjitha dokumentet e bashkangjitur, dhe do të njoftojë së shpejti aplikantin në lidhje me vendimin e saj, brenda një periudhe të arsyeshme kohore.
- 6.2. Nëse aplikacioni që i është dhënë ZRRE-së është i pakompletuar, ZRRE-ja mund të kërkojë që aplikanti të ofrojë informatat e nevojshme shtesë, brenda periudhës së specifikuar.
- 6.3. Në rast se aplikacioni dhe dokumentet shtesë nuk janë në përputhje me kriteret e përcaktuar në këtë Rregull dhe ligjet e aplikueshme, ZRRE-ja do të kërkojë nga aplikanti, të korrigjojë me shkrim aplikacionin e tij brenda periudhës kohore të specifikuar nga ZRRE-ja. Periudha e shqyrtimit të aplikacionit do të fillojë që nga data e aplikacionit të korrigjuar ose të kompletuar.
- 6.4. Nëse aplikanti nuk korrigjon aplikacionin e tij, ose nuk dorëzon dokumentet ose informatat që mungojnë brenda periudhës së përcaktuar, ZRRE-ja do të vendosë mbi aplikacionin, bazuar në dokumentet ekzistuese dhe informatat e ofruara, dhe aplikanti do të informohet për vendimin e ZRRE-së me shkrim. ZRRE-ja mund të refuzojë dhënien e Lejes për ndërtim për shkak të mosdorëzimit të informacioneve të domosdoshme.

- 6.5. Në vlerësimin e aplikacionit për dhënien e lejes për ndërtim dhe aplikacionit për liçencë ZRRE, pas konsultimit me aplikantin, mund të kryejë studim të pavarur të ndonjë aspekti të aplikacionit. Aplikanti do të bartë vetëm ato shpenzime të domosdoshme dhe të arsyeshme të asaj studimi të pavarur. Sipas kërkesës së aplikantit ZRRE-ja do të siguroj arsyetimin në detaje për të gjitha shpenzimet. Në rast të paraqitjes së kontestit në lidhje me domosdoshmërinë e arsyeshmërisë së shpenzimeve, aplikanti mund të kërkoj shqyrtim gjyqësor.

Neni 7

Rregullat Procedurale

- 7.1. Pas përcaktimit nga ana e ZRRE-së, se aplikacioni për liçencë është i plotë, ZRRE-ja do të udhëzojë aplikantin për liçencë, që të botojë në dy (2) gazeta ditore me qarkullim të gjerë në Kosovë:
- a) një përmbledhje të shkurtër të aplikacionit për liçencë;
 - b) një njoftim se ZRRE-ja po fillon shqyrtimin e aplikacionit dhe se palët e interesuara mund të paraqesin synimin e tyre për të marrë pjesë në ZRRE brenda dy (2) javësh prej datës së botimit të përmbledhjes së aplikacionit.
- 7.2. ZRRE-ja do të postojë në faqen e vet zyrtare elektronike, përmbajtjen e publikimit siç përcaktohet në Nenin 7.1.
- 7.3. Palët që kërkojnë pjesëmarrjen në shqyrtim, mund të paraqesin në ZRRE një përmbledhje të natyrës së interesit të tyre, ndonjë kundërshtim ndaj liçencës ose një listë të çështjeve shqetësuese. Kjo përmbledhje do të postohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.
- 7.4. Brenda dy (2) javësh pas afatit përfundimtar të vendosur në pajtim me paragrafin 7.1. b), dhe pas konsultimit me aplikantin për liçencë dhe palët pjesëmarrëse, ZRRE-ja mund të krijojë një plan fillestar për marrjen në konsideratë dhe shqyrtim të aplikacionit. Plani mund të përshijë:
- a) një periudhë të arsyeshme për palët që të kërkojnë informacione shtesë nga aplikanti dhe/ose nga ZRRE-ja;
 - b) një periudhë të arsyeshme për dorëzimin e komenteve me shkrim;
 - c) dëgjime publike, siç kërkohet sipas paragrafit 7.5.
- 7.5. Pjesëmarrja publike për aplikacione për liçencë dhe leje ndërtimi mund të përfshijë edhe:
- a) çdo dëgjim publik, siç përcaktohet nga ZRRE-ja;
 - b) takime konsultuese midis përfaqësuesve të ZRRE-së dhe ndërmarrjes për energji, konsumatorëve ose palëve të tjera të interesuara; dhe
 - c) forma të tjera të pjesëmarrjes që ZRRE-ja mund t'i konsiderojë si të përshtatshme.

- 7.6. Kërkesat për informacione, sipas Nenit 7.4. a), të cilat janë të arsyeshme dhe nuk vendosin një mbingarkesë mbi ZRRE-në ose aplikantin, dhe nuk kërkojnë lëshimin e informacioneve të besueshme, do të merren parasysh dhe informacioni do të sigurohet.
- 7.7. ZRRE-ja do të përpiqet të lehtësojë qasjen në çdo informacion jo të fshehtë nga aplikanti me kohë. Nëse një palë beson se kërkesa e tij i është refuzuar në mënyrë të paarsyeshme, ose nëse ndonjë palë beson se kërkesa nuk po plotësohet në mënyrë të arsyeshme dhe me kohë, pala mund të paraqet petitionin për zgjidhje tek ZRRE-ja duke kërkuar qasjen.
- 7.8. Shqyrtimi i të gjitha aplikacioneve për liçenca dhe leje ndërtimi, përveç atyre për liçenca furnizimi/tregtimi, do të përfshijnë të paktën një dëgjim publik.

KAPITULLI 3

LEJET PËR NDËRTIMIN E STABILIMENTEVE TË REJA PËR ENERGJI DHE LINJAVE DIREKTE

Neni 8

Kriteret për Lëshimin e Lejeve për Ndërtim

- 8.1. Në bazë të Kapitullit 8 të Ligjit mbi Rregullatorin e Energjisë dhe dispozitave relevante të Ligjit mbi Ngrohjen Qendrore, për ndërtimin e stabilimenteve të reja për energji dhe linjave direkte, nevojitet leje për ndërtim.
- 8.2. Ky Rregull ofron kornizën e përgjithshme për aplikim në ZRRE për leje ndërtimi. Ashtu siç është përcaktuar në Kapitullin 1, Neni 1.5, dokumenti i veçantë, Rregulli mbi Autorizimin dhe legjislacioni që përdoret për procedurën e tenderimit, do të përcaktoj kriteret e detajuara sipas të cilave ZRRE-ja do të lëshoj lejet për ndërtim.

Neni 9

Përfundimi i Ndërtimit

- 9.1. Pas përfundimit të ndërtimit të stabilimentit për energji në përputhje me lejen e ndërtimit, mbajtësi i lejes së ndërtimit, do të dorëzojë në ZRRE të gjitha dokumentet që kërkojnë për liçencë, sipas Kapitullit 4-6 të këtij Rregulli, që nuk kanë qenë dorëzuar më herët në ZRRE si pjesë e procesit të lejimit të ndërtimit.
- 9.2. Nëse ZRRE-ja përcakton se janë plotësuar kushtet për lejen e ndërtimit dhe janë dorëzuar të gjithë dokumentet e kërkuar, ZRRE-ja do të bëjë të gjitha përpjekjet për të lëshuar një liçencë sa më shpejt dhe brenda afatit të arsyeshëm kohor.

Neni 10

Mos-përmbushja e Kushteve

- 10.1. Nëse ZRRE-ja përcakton se kushtet për lejen e ndërtimit nuk janë plotësuar, do të njoftojë aplikantin se cilat kushte nuk janë plotësuar dhe masat të cilat duhet të ndërmerret aplikanti për plotësimin e kushteve.
- 10.2. Aplikanti mund të kundërshtojë vendimin e ZRRE-së për mosplotësimin e kushteve të tij duke ofruar, brenda katërbëdhjetë (14) ditëve nga dita e pranimit të njoftimit, një plotësim se përse beson se i ka plotësuar kushtet.
- 10.3. Asnjë liçencë nuk do të lëshohet derisa ZRRE-ja të përcaktojë se janë plotësuar kushtet për dhënien e lejes për ndërtim dhe se janë siguruar të gjitha dokumentet e kërkuara.

KAPITULLI 4

APLIKACIONI PËR LIÇENCË: KËRKESAT E PËRGJITHSHME

Neni 11

Informatat dhe Dokumentet e Kërkuar nga të gjithë Aplikantët për Liçencë

- 11.1. Liçencat do të kërkohen për aktivitete të energjisë ashtu siç është përcaktuar në Nenin 28.2 të Ligjit mbi Rregullatorin e Energjisë, Nenin 27 të Ligjit mbi Energjinë Elektrike dhe Ligjit mbi Ngrohjen Qendrore.
- 11.2. Aplikacioni për liçencë do të përmbajë të gjitha informatat e aplikueshme të kërkuara në këtë Rregull dhe në Shtojcën 1 të këtij Rregulli.
- 11.3. Secili aplikant kur të aplikojë për liçencë, duhet të dorëzojë tek ZRRE-ja dokumentet në vazhdim:
 - a) vërtetimin e regjistrimit të aplikantëve si Organizatë Afariste, të lëshuar nga agjencia e autorizuar për regjistrimin e organizatave afariste;
 - b) planin afarist të aplikantit që përfshin së paku tre (3) vjet;
 - c) gjendjen financiare vjetore të aplikantit për tre (3) vjetët e fundit ku gjendja vjetore financiare e aplikantit i nënshtrohet një kontrolli të pavarur financiar, aplikanti do të dorëzojë raportin e auditorëve veçmas nga gjendja financiare;
 - d) vërtetimin nga një institucion financiar ose institucione që konfirmojnë ekzistencën e fondeve të aktiviteteve për energji, garancinë e bankës së aplikantit apo kompanisë mëmë në rast të subvencionit, ose evidencë të ngjashme të fondeve të mjaftueshme për të financuar aktivitetin për të cilin kërkohet liçenca;
 - e) një kopje e regjistrimit të ndarjes së aksioneve ose të pjesëmarrjes së njëjtë të secilit aksionar ose partner të aplikantit dhe kopjet e të gjithë dokumenteve të nevojshme (Neneve shoqërues, vendimin e gjykatës ose kopje të librit të aksionarëve, etj.) për të evidentuar këto raporte të hollësishme;

- f) vërtetimin që aplikanti është pagues i rregullt i taksave;
 - g) certifikatën e lëshuar nga gjykata kompetente që vërteton se aplikanti nuk i është nënshtruar procedurave për mospagesë apo likuidim;
 - h) detajet e përvojës së aplikantit për kryerjen e aktiviteteve të tilla për energji në formë të biografisë (Curriculum Vitae) “CV”;
 - i) informacione në lidhje me strukturën drejtuese dhe organizative të aplikantit;
 - j) CV-të (biografinë) e stafit menaxhues të aplikantit dhe listën e stafit tjetër të lartë, si dhe kualifikimet e tyre;
 - k) dëftesat e pagesës së taksave të aplikueshme.
- 11.4. Aplikanti do të dorëzojë një deklaratë të nënshkruar që dëshmon që i plotëson kriteret ligjore të përcaktuar në ligjet ose rregulloret në Kosovë, dhe se nuk ka shënime mbi shkelje të mëparshme në Kosovë apo jashtë saj për sa i përket:
- a) kushteve të sigurisë dhe të mbrojtjes në punë;
 - b) kriterëve teknike në lidhje me operimin e termocentraleve dhe sistemeve të prodhimit të energjisë elektrike/ngrohjes;
 - c) mbrojtjes së mjedisit.

Neni 12 Deklarata

Përveç dokumenteve të renditura në Nenin 11, aplikanti do të dorëzojë në ZRRE një deklaratë që:

- a) menaxherët e aplikantit nuk janë dënuar për krim kundër pronës, dhe nuk janë dënuar për korrupsion ose mashtrim, pavarësisht nga afati i burgimit;
- b) licenca e aplikantit për aktivitetin e njëjtë nuk është tërhjekur brenda pesë (5) vjetëve që nga data kur është dorëzuar aplikacioni;
- c) aplikanti nuk ka ri-aplikuar për licencë më herët se nëntëdhjetë (90) ditë pas datës së vendimit të refuzimit;
- d) ekzistojnë të gjitha aprovimet e nevojshme për ndërtimin dhe mbrojtjen e ambientit, ose aprovime të tjerë të specifikuar në ligje të ndryshëm;
- e) aplikanti i kupton dhe është i vetëdijshëm për obligimet e tij që të përfill legjislacionin e aplikueshëm mbi energjinë, përfshirë ligjet, rregullat e lëshuar nga ZRRE-ja, gjithë kodet e rëndësishme teknike dhe komerciale dhe legjislacionin tjetër të aplikueshëm.

Neni 13 Aplikacioni nga Ndërmarrjen e Sapo Krijuar

- 13.1. Nëse aplikanti është një ndërmarrje e themeluar rishtazi, do të paraqesë të gjithë dokumentet e renditur në Nenet 11 dhe 12, me përjashtim të dokumenteve të përshkruara në Nenin 11.3 c) dhe h).

- 13.2. Ky aplikant do të dorëzojë deklaratën financiare dhe informacione në lidhje me përvojën e partnerëve ose aksionarëve të tij, nëse ka, në përmbushjen e aktiviteteve të ngjashme për energji.

Neni 14

Afati i Vendimit për Aplikacion të Liçencës

ZRRE-ja do të bëjë të gjitha përpjekjet që të lëshojë liçencën në mënyrë të shpejtë. Kjo periudhë nuk do të jetë më e gjatë se tre (3) muaj nga data e dorëzimit të të gjithë dokumentacionit të kërkuara nga aplikanti.

KAPITULLI 5

APLIKIMET PËR LIÇENCË: KRITERET SPECIFIKË NDAJ SECILËS KATEGORI TË APLIKANTËVE PËR LIÇENCË

Neni 15

Aplikacioni për Liçencat e Prodhimit

Një aplikant për prodhimin e energjisë elektrike dhe ngrohjes, duhet të dorëzojë në ZRRE aplikacionin dhe materialin në vazhdim:

- a) të dhëna mbi llojin dhe specifikat teknike të stabilimenteve për energji dhe vendndodhjes, duke përfshirë edhe listën e stabilimenteve kryesore dhe atyre ndihmëse të vendit energjetik;
- b) dëshmi mbi sigurimin e karburantit dhe/ apo kontratën paraprake apo finale mbi furnizimin me karburant;
- c) planin afarist në përputhshmëri me obligimet të lidhura me aktivitet të liçencuar;
- d) çdo Marrëveshje për Lidhjen që ekziston;
- e) lejen për mbrojtje të ambientit sipas Ligjit Nr. 2002/8 për Mbrojtjen e Ambientit;
- f) planin për dekomisionim dhe rehabilitim;
- g) dëshmi për të drejtat pronësore, mbi/ose të drejtën ligjore për të shfrytëzuar stabilimentet e propozuara për kryerjen e aktiviteteve të liçencuara, të shoqëruar me skica dhe harta të pronës dhe stabilimenteve përkatëse;
- h) çdo kontratë për furnizim publik në formën përfundimtare nëse është e mundur, apo edhe në formë të draftit, me arsyetimin për sa i përket statusit të negociatave;
- i) deklarin për efikasitet termal;
- j) lejen për furnizim me ujë, në rast të liçencës për prodhim të energjisë elektrike nga hidrocentrali;
- k) vlerësimin e kostos së energjisë së prodhuar gjatë kohëzgjatjes së kapaciteteve të reja prodhuese ose kohëzgjatjes së mbetur të stabilimentit të rehabilituar.

Neni 16

Aplikacioni për Liçencë për Operator të Sistemit të Transmetimit

Një aplikant për liçencë për operator të sistemit të transmetimit të energjisë elektrike , duhet të dorëzojë materialin në vazhdim:

- a) përshkrim të karakteristikave të sistemit të transmetimit përkatës për transmetimin e energjisë elektrike dhe dëshmi të drejtave pronësore, për/ose të drejtën ligjore për të shfrytëzuar elementet e sistemit;
- b) planin afarist që përmban informacione mbi parashikimin e kërkesave dhe planin e zhvillimit të sistemit, siç përcaktohet në Nenin 13.1 të Ligjit mbi Energjinë Elektrike, duke përfshirë edhe ndikimin e zhvillimit të sistemit në tarifën e aprovuara nga ZRRE-ja sipas Metodologjisë së Tarifave;
- c) informacione mbi kapacitetet ndërkufitare;
- d) demonstrimin (deklaratën) e posedimit të sistemit të harduerit dhe softuerit të nevojshëm për përlogaritjen e rrjedhave të ngarkesës, për menaxhimin e dispeçimit të centralit për energji, shërbimeve ndihmës dhe lidhjeve të shkurta stabiliteti dinamik i tregut të balancimit, dhe për menaxhimin e kongestionit, nëse është e aplikueshme dhe deklaratën për blerjen ose sigurimin e sistemeve të përmendura;
- e) specifikimet dhe karakteristikat teknike të pajisjeve matëse në pikat e faturimit të energjisë elektrike;
- f) deklarin se aplikanti është i vetëdijshëm për obligimet e tij të zhvilloj dhe implementoj të gjitha kodet teknike siç parashihet në Nenin 38.7 të Ligjit mbi Energjinë Elektrike;
- g) deklarin që të gjitha kode komerciale si dhe Rregulli i Tregut do të implementohen.

Neni 17

Aplikacioni për Liçencë për Operator Tregu

Aplikanti për liçencë për Operator Tregu duhet të dorëzojë dokumentacionin vijues:

- a) planin afarist që përmban informata për parashikimin e zhvillimit të tregut;
- b) demonstrimin e posedimit të harduerit dhe softuerit të nevojshëm për komunikim me të gjitha pikat matëse, me të gjithë pjesëmarrësit e tregut duke përfshirë edhe OST-në, për zgjidhjen dhe sistemet për rregullim e tregut të balancuar;
- c) deklaratën se aplikanti është i vetëdijshëm për obligimet e tij të zhvilloj Rregullat e Tregut.

Neni 18

Aplikacioni për Liçencat e Shpërndarjes

Një aplikant për liçencën e shpërndarjes së energjisë elektrike dhe ngrohjes, duhet të dorëzojë materialin në vazhdim :

- a) një përshkrim të karakteristikave përkatëse të sistemit të shpërndarjes dhe territorit për shpërndarjen e energjisë elektrike dhe ngrohjes;

- b) informatë në lidhje me pronësinë ose të drejtën legale të përdorimit të elementeve të sistemit;
- c) planin afarist që përveç informacioneve të tjera, përfshin edhe parashikimin e kërkesave dhe planin zhvillimor të sistemit, siç përcaktohet në Nenin 18.1 të Ligjit mbi Energjinë Elektrike dhe në dispozitat relevante të Ligjit për Ngrohjen Qendrore;
- d) informacione mbi numrin dhe strukturën e konsumatorëve të kyçur ose të numrit dhe strukturës së konsumatorëve potencialë;
- e) demonstrimin e posedimit të sistemeve të harduerit dhe softuerit të nevojshëm për llogaritjen e rrjedhave të ngarkesës të sistemit energjetik, lidhjeve të shkurta dhe deklaratën për blerjen ose sigurimin e sistemeve të përmendura;
- f) treguesit për matjen për furnizim të pandërprerë (kohëzgjatja, frekuenca, numri i ndërprerjeve, ndërprerjet e shprehura në minuta për konsumator) dhe shërbimet në operimin e sistemit (koha e kyçjes, rivendosja e sistemit energjetik pas dështimeve, dështimet, marrëveshjet për leximin e njehsorëve si dhe informatat e përgjithshme);
- g) specifikimet dhe karakteristikat teknike të pajisjeve matëse të sistemit të shpërndarjes.

Neni 19

Aplikacioni për Liçencë për Furnizim Publik

Kur të bëhet aplikimi për liçencë për furnizim me energji elektrike dhe ngrohje, aplikanti do të dorëzojë materialin në vazhdim:

- a) planin afarist që përfshinë standardet e përmbushjes për furnizimin e konsumatorëve, duke përfshirë elementet e lidhur me furnizimin, siç janë: koha e përgjigjes ndaj letrave të konsumatorëve, marrja me ankesat e konsumatorëve, propozimet për faturimin, koha e përgjigjes në qendrën thirrëse, koha mesatare e pritjes në qendrat për informim të konsumatorëve;
- b) të dhëna mbi burimet materiale që i posedon aplikanti duke përfshirë të dhëna për sistemin informativ dhe softuerin në dispozicion për kryerjen e aktiviteteve.

Neni 20

Aplikacioni për Liçenca për Furnizim/Tregti

Gjatë aplikimit për liçencë për furnizim/tregti, parashtruesi i kërkesës duhet të paraqes dokumentacionin si në vijim:

- a) shënimet mbi burimet materiale në pronësi të aplikantit, duke përfshirë shënimet mbi sisteme informative dhe posedimin e softuerit për ushtrimin e veprimtarisë;
- b) çdo Marrëveshje për Lidhjen që ekziston;
- c) dëshminë që ka në dispozicion stafin të nevojshëm, dhe kualifikimet dhe përvojën e tyre në ushtrimin e aktiviteteve për energji, si dhe strukturën organizative të aplikantit;

- d) deklaratën që pas lëshimit të liçencës, i liçencuari do të siguroj garanci të duhura financiare për të siguruar përmbushjen e obligimeve për të gjitha transaksionet që do të implementohen pas nxjerrës së liçencës.

KAPITULLI 6

KRITERET PËR DHËNIEN E LIÇENCËS

Neni 21

Kriteret e Përgjithshme për Dhënien e Liçencës

Liçenca mund t'i lëshohet aplikantit nëse ai dëshmon se:

- a) posedon aftësi teknike dhe financiare, burime materiale dhe njerëzore dhe strukturë organizative, në përputhje me kërkesat rregullative sipas liçencës së tij;
- b) ka të drejtë pronësore ose të drejtën ligjore për të përdorur stabilimentet për energji për të përmbushur aktivitetet;
- c) siguron prova që stabilimentet e energjisë që do të shfrytëzohen për të përmbushur aktivitetet, i plotësojnë kriteret e sigurisë dhe të mbrojtës së ambientit;
- d) nuk do të degradojë funksionimin e sistemit energjetik dhe të ngrohjes;
- e) do të operojë në përputhje me Strategjinë për energji të miratuar nga Qeveria e Kosovës;
- f) nuk do të rrezikojë ose përkeqësojë zhvillimin e konkurrencës në një treg të hapur;
- g) i plotëson të gjithë kriteret dhe udhëzimet përkatëse mjedisore të Kosovës dhe të Direktivave të BE-së dhe ka sigurim dhe programe monitorimi të përshtatëm dhe të vazhdueshëm për cilësinë e ambientit.

Neni 22

Kriteret e Veçanta për Dhënien e Liçencës

22.1. Përveç kriterëve të përgjithshme të përcaktuar në Nenin 21, aplikanti për Liçencën e Prodhimit, duhet të dëshmojë se:

- a) ka kapacitet financiar dhe teknik që të rregullojë të gjitha mbeturinat që lidhen me prodhimin dhe t'i shkarkojë dhe /apo largojë të gjitha stabilimentet prodhuese në përputhje me kërkesat teknike dhe të mjedisit;
- b) ka aftësi të siguroj shërbimet ndihmëse;
- c) përdor teknologjinë moderne;
- d) posedon sigurimin adekuat të lëndës djegëse.

22.2. Përveç kriterëve të përgjithshme të përcaktuar në Nenin 21, aplikanti për Liçencë për Operimin e Sistemit të Transmetimit duhet të dëshmojë se:

- a) posedon pajisje matëse në pikat e transmetimit të energjisë elektrike;

- b) ka themeluar një sistem efikas për leximin e njehsorëve për qëllimin e faturimit të energjisë elektrike;
 - c) mundëson qasjen e palës së tretë në sistemin e transmetimit të energjisë elektrike;
- 22.3. Përveç kritereve të përgjithshme të përcaktuar në Nenin 21, aplikanti për Liçencë për Operimin e Sistemit të Shpërndarjes, duhet të vërtetojë se:
- a) posedon pajisje matëse në pikat e shpërndarjes së energjisë elektrike/ngrohjes;
 - b) ka themeluar një sistem efikas për leximin e njehsorëve për qëllimin e faturimit të energjisë elektrike dhe ngrohjes;
 - c) mundëson qasjen e personave të tretë në sistemin e shpërndarjes së energjisë elektrike dhe ngrohjes;
- 22.4. Përveç kritereve të përgjithshëm të përcaktuar në Nenin 21, aplikanti për Liçencë për Furnizim Publik, duhet të dëshmojë se:
- a) të gjitha kërkesat për pajisjet e domosdoshme matëse dhe të faturimit për shpenzimin e energjisë elektrike dhe ngrohjes për konsumatorët e rregulluar, janë plotësuar në një mënyrë të sigurt dhe ekonomike;
 - b) i përmbush Detyrimet e Shërbimeve Publike, nëse kjo aplikohet në rastin konkret;
- 22.5. Përveç kritereve të përgjithshëm të përcaktuar në Nenin 21, aplikanti për Liçencë për Furnizim/Tregti, duhet të dëshmojë se:
- a) të gjitha kërkesat për pajisjet e domosdoshme matëse dhe të faturimit për shpenzimin e energjisë elektrike dhe ngrohjes, janë plotësuar në një mënyrë të sigurt dhe ekonomike;
 - b) tregtari/ furnizuesi gëzon reputacion të mirë.

KAPITULLI 7

KUSHTET DHE KONDITAT E LIÇENCAVE

Neni 23

Termet dhe Kushtet e Përgjithshme

- 23.1. Secila liçencë duhet të përfshijë afatet dhe kushtet për përmbushjen e aktivitetit të liçencuar, vendosjen e të drejtave dhe detyrimeve të imponuara ndaj të gjithë ose shumicës së të liçencuarve, pavarësisht nga lloji i aktiviteteve për energji.
- 23.2. Secila liçencë duhet të përmbajë dispozitat e përgjithshme në vazhdim:
- a) llojin e aktivitetit të energjisë së liçencuar;
 - b) përkufizimet dhe dispozitat e interpretimit;

- c) bazat ligjore për lëshimin e liçencave;
- d) përmbushjen e aktiviteteve të liçencuara;
- e) territoret e mbuluar nga liçenca, nëse është e aplikueshme;
- f) pronësinë apo të drejtën ligjore për të shfrytëzuar territorin, stabilimentin dhe pjesët përbërëse të sistemit;
- g) stabilimentet kryesore të përdorur për të kryer aktivitetet e liçencuara nëse është e aplikueshme;
- h) afatet, kushtet, të drejtat dhe detyrimet e të liçencuarve;
- i) kriteri për t'u përshtatur me të gjithë kodet përkatës teknikë dhe komercial, përfshirë Rregullin e Tregut, për sa janë të aplikueshëm;
- j) domosdoshmërinë e përputhjes me kushtet e përcaktuara në liçencat e tyre, ligjet dhe rregulloret e aplikueshme në Kosovë, si dhe Rregullat e nxjerra nga ZRRE-ja;
- k) dispozitat e standardeve të kontabilitetit;
- l) ndalimin e subvencionimit të tërthortë (ndër-subvencionimi) nëse është i aplikueshëm;
- m) detyrimet e shërbimeve publike dhe dispozitat për furnizimin si mase e fundit, nëse është e aplikueshme;
- n) lidhur me integritetin dhe stabilitetin financiar të të liçencuarit;
- nj) domosdoshmërinë e përputhjes me kriteret e sigurisë, si dhe mbrojtjen e ambientit siç përcaktohet në legjislacione të ndryshme;
- o) konditat në lidhje me modifikimin, tërheqjen, ndërprerjen, transferimin dhe braktisjen e liçencës;
- p) obligimin që të mbaj shënime nga aktivitetet e liçencuara sipas kërkesës së ZRRE;
- r) lidhur me informimin e ZRRE-së, raportimin dhe monitorimin;
- s) lidhur me pagesën e taksave;
- t) lidhur me zgjidhjen e kontesteve dhe procedurën e ankesës;
- u) pasojat ligjore të shkeljes së kriterëve të liçencës.

23.3. Përpos kushteve në Nenin 23.2, ZRRE-ja mund të konsideron edhe kushte tjera të domosdoshëm me qëllim që të sigurojë përputhshmërinë me objektivat ose kërkesat e legjislacionit të aplikueshëm, këtë Rregull dhe rregullat e tjerë të lëshuar nga ZRRE-ja;

Neni 24

Termet dhe Kushtet e Veçanta në Llojet e Ndryshme të Liçencave

24.1. Në Liçencën e Prodhimit ZRRE-ja mund të përfshijë edhe termat dhe kushtet që kanë të bëjnë me:

- a) sigurimin e shërbimeve ndihmëse nga i liçencuari, në përputhje me mundësitë teknike dhe rregulloret teknike dhe komerciale të tregut të energjisë;
- b) sigurimin e dispeçit sipas Rregullave të Tregut dhe Kodit të Rrjetës;
- c) kriterin për krijimin e raporteve me aktorë të tjerë të tregut të energjisë elektrike dhe ngrohjes, në përputhje me Rregullat e Tregut, rregulloret, ligjet dhe rregullat e aplikueshme në Kosovë;
- d) kriterin që i liçencuari të sigurojë matjet e nevojshme të ndikimit në ambient, në përputhje me ligjet e ambientit;

- e) krijimin e një programi përputhshmërie, i cili përcakton masat e marra për garantimin e aktiviteteve jo-diskriminuese në lidhje me dispozitat e Rregullave të Tregut dhe monitorimin adekuat të këtyre aktiviteteve;
- f) sigurimin e rezervave të lëndës djegëse (për gjenerator publik);
- g) rregullimin e qasjes në tokën dhe/ose në stabiliment;
- h) heqjen apo dhënien për shfrytëzim të pronës të të Liçencuarit;
- i) dekomisionimin dhe/ose heqjen e gjithë stabilimenteve dhe strukturave, dhe të kthejë tokën në gjendjen e saj fillestare, nëse është e mundshme.

24.2. Në Liçencën për Transmetim, ZRRE-ja mund të përfshijë termat dhe kushtet që kanë të bëjnë me:

- a) kërkesën që të siguroj lidhjen në sistemin e transmetimit dhe qasjen e palës së tretë në një mënyrë objektive dhe jo diskriminuese, sipas dispozitave të përshtatshme që qeverisin dorëzimin e kërkesave për qasjen, procedurave për mohimin e qasjes dhe procedurave të ankimit nga ana e palëve që u është mohuar qasja;
- b) shpërndarjen e energjisë së prodhuar nga burimet e ripërtëritshme të energjisë sipas Nenit 11 të Ligjit të Energjisë dhe rregullave dhe rregulloreve tjera përkatëse;
- c) obligimin që të publikohen informatat për kapacitete ndërlidhjeje një vjet paraprakisht, për mirëmbajtje të sistemit të transmetimit dhe kongestion të mundur;
- d) planet për zhvillimin e sistemit të transmetimit sipas Nenit 13.1 k) të Ligjit mbi Energjinë Elektrike dhe standardeve të aplikueshëm;
- e) detyrimin për të mbajtur të dhënat dhe kriteri që informacioni i marrë prej shfrytëzuesve të sistemit të transmetimit, të jetë i hapur ndaj publikut, por të ruhet fshehtësia e informacionit;
- f) sigurimin e informacioneve të tregut dhe teknike për shfrytëzuesit e tjerë të sistemit;
- g) krijimin e një programi përputhshmërie i cili nxjerr masat e marra për të siguruar përjashtimin e sjelljes diskriminuese të pjesëmarrësve në tregun dhe për të siguruar monitorimin adekuat të tij;
- h) detyrimin për të zhvilluar kodet teknike siç paraqitet në Ligjin mbi Energjinë Elektrike.
- i) përgjegjësi të tjera të operatorit të sistemit të transmetimit, siç përshkruhet në Nenin 13.1. të Ligjit mbi Energjinë Elektrike;

24.3. Në Liçencën për Shpërndarje, ZRRE-ja mund të përfshijë termat dhe kushtet që kanë të bëjnë me:

- a) kërkesën që të siguroj kyçjen dhe shfrytëzimin në sistemin e shpërndarjes dhe qasjen e palës së tretë në një mënyrë objektive dhe jo diskriminuese, sipas dispozitave të përshtatshme që qeverisin dorëzimin e kërkesave për qasjen, procedurave për mohimin e qasjes dhe procedurave të ankimit;
- b) karakteristikat e sistemit dhe ndërlidhjet;

- c) planet për zhvillimin e sistemit të shpërndarjes siç përshkruhet në Nenin 18.1. d) dhe e) të Ligjit mbi Energjinë Elektrike dhe sipas dispozitave relevante të Ligjit për Ngrohje Qendrore;
- d) sigurimin i informacioneve për shfrytëzuesit e tjerë të sistemit;
- e) krijimin i një programi përputhshmërie siç përshkruhet në Nenin 17.3. d) të Ligjit mbi Energjinë Elektrike;
- f) dispozitat që sigurojnë qasje jo diskriminuese në informata por duke ruajtur fshehtësinë e informacionit;
- g) informimin e konsumatorëve në mënyrë transparente dhe të qartë mbi kushtet e kyçjes për kyçje në sistemin e shpërndarjes;
- h) përcaktimin që të gjithë kërkesat për matjet dhe faturimet për konsumatorët e privilegjuar janë të përmbushura në mënyrë të sigurt dhe ekonomike;

24.4. Në Liçencën për Furnizim Publik ZRRE-ja mund të përfshijë edhe kushtet:

- a) e paraqitur në Nenin 21 të Ligjit mbi Energjinë Elektrike në lidhje me furnizimin publik të konsumatorëve me energji elektrike dhe dispozitat relevante në lidhje me furnizim publik me ngrohje sipas Ligjit të Ngrohjes Qendrore;
- b) dispozitat në lidhje me furnizimin si masë të fundit, në mënyrë që të sigurojë vazhdimësinë e furnizimit të konsumatorëve me energji elektrike dhe ngrohje.
- c) e hartuara për të siguruar që mbajtësi i liçencave do ti informojë të gjithë konsumatorët mbi procedurat për të bërë një kërkesë për dëmtime, si dhe themelon procedurat e duhura për tu marrë me kërkesa të tilla;
- d) parandalimin e diskriminimit në dhënien e shërbimeve konsumatorit.

24.5. Në Liçencën për Furnizim/Tregtim ZRRE-ja mund të përfshijë kushtet:

- a) të paraqitura në Nenin 22 dhe 23 të Ligjit mbi Energjinë Elektrike dhe në dispozitat e Ligjit për Ngrohjen Qendrore në lidhje me furnizimin/ tregtimin ndaj konsumatorëve të privilegjuar;
- b) kërkesat për blerjen e energjisë elektrike dhe ngrohjes në mënyrë ekonomikisht më efektive;
- c) e hartuara për të siguruar që mbajtësi i liçencave do ti informojë të gjithë konsumatorët mbi procedurat për të bërë një kërkesë për dëmtime, si dhe themelon procedurat e duhura për tu marrë me kërkesa të tilla;
- d) parandalimin e diskriminimit në dhënien e shërbimeve konsumatorit;

24.6. Në Liçencën e Operimit të Tregut, ZRRE-ja mund të përfshijë terma dhe kushte:

- a) që paraqiten në Nenin 27.3 të Ligjit mbi Energjinë Elektrike;
- b) për të përgatitur dhe zbatuar Rregullat e Tregut siç përshkruhet në Nenin 27.5 të Ligjit mbi Energjinë Elektrike;
- c) për dërgimin e informatave të sakta dhe besueshme sa i përket çmimeve, numrin e pjesëmarrësve të tregut, përqindje të aksioneve në treg, çmimeve që parashihen dhe statistikat e pjesëmarrësve të tregut.

Neni 25

Aktivitetet e Ndara

Çdo aktivitet do të liçencohet veçmas. Nëse një aplikant ka aplikuar për më shumë se një liçencë për kryerjen e aktiviteteve të ndryshme të liçencuara, ZRRE-ja do të nxjerrë liçenca të veçanta për çdo aktivitet të liçencuar.

Neni 26

Kriteret për Ndarjen e Llogarive dhe Menaxhimit

- 26.1. I liçencuari është i detyruar të mbajë llogaritë të veçanta për:
- a) aktivitete të ndryshme për energji, përfshirë prodhimin, transmetimin, shpërndarjen, furnizimin dhe tregtimin e energjisë si dhe transitin e energjisë elektrike;
 - b) aktivitetet që kryen i liçencuari jashtë fushëveprimit të liçencës;
 - c) aktivitetet e ndara të kryera brenda tregjeve të rregulluar dhe të parregulluar të energjisë elektrike dhe ngrohjes.
- 26.2. ZRRE-ja nuk do të aktivizojë kushtin ku kërkohet kontabilitet dhe menaxhim i veçantë në rastet e aktiviteteve të energjisë të pa-rregulluara, ku mungesa e tij nuk e rrezikon konkurrencën.
- 26.3. Të Liçencuarit i kërkohet të ushtrojë ndarjen e kontabilitetit, menaxhimit dhe ndarjen ligjore në përputhje me kriteret e paraqitur në Direktivën e Bashkimit Evropian, Nr. 2003/54/EC.

Neni 27

Kohëzgjatja e Liçencës

- 27.1. Përveç sipas Nenit 49.2 të Kushteve të Përkohshme, kohëzgjatja e liçencës do të përcaktohet në përputhje me Nenin 31 të Ligjit mbi Rregullatorin e Energjisë, i cili përcakton periudhën e liçencës që aplikohet ndaj llojeve të ndryshme të aktiviteteve për energji.
- 27.2. Faktorët që merren parasysh nga ZRRE-ja për përcaktimin e kohëzgjatjes së një liçence prodhimi për një kapacitet prodhimi të ndërtuar rishtas janë:
- a) jetëgjatësia teknike e pjesëve kryesore të centralit ekzistues të energjisë elektrike dhe ati të ngrohjes qendrore, përfshirë pajisjet ndihmëse të nevojshme për operim, të konfirmuara nga autoriteti për sigurinë teknike;
 - b) politika amortizuese (e zhvlerësimit) për entitetin prodhues dorëzuar me aplikimin për liçencë;
 - c) kërkesa e aplikantit.

27.3. Faktorët që merren parasysh nga ZRRE-ja për përcaktimin e kohëzgjatjes së një liçence për bashkë-prodhim të energjisë elektrike dhe/ose prodhimin e ngrohjes për kapacitetet ekzistuese, përfshijnë:

- a) burime të tjera potenciale të ngrohjes që shërbejnë për ngrohje të konsumatorëve;
- b) mendimi i autoriteteve lokale përgjegjëse për ngrohjen qendrore, nëse ka.

KAPITULLI 8

QASJA NË TË DHËNAT DHE KRITERET PËR RUAJTJEN

Neni 28

Detyrimet Vjetore të të Liçencuarit

Sipas termave dhe kushteve të paraqitur në liçencën e tij, i liçencuari duhet të dorëzojë në ZRRE në baza vjetore, dokumentet vijues:

- a) informacionin financiar dhe të kontabilitetit dhe dokumente të tjerë të kontabilitetit, përfshirë bilancet vjetorë të çertifikuar së bashku me deklaratat mbi të ardhurat dhe shpenzimet, informacione mbi asetet dhe detyrimet për degët dhe aktivitetet, dhe informacione mbi rregullat e aplikuar që ndikojnë në alokimet e përmendura të të hollave;
- b) informacione të specifikuar teknike dhe ekonomike, përfshirë raportin vjetor mbi mirëmbajtjen e sigurisë dhe mbrojtjes së stabilimenteve për energji, për implementimin e investimeve, programet prodhuese dhe të mirëmbajtjes;
- c) çdo kontratë të nënshkruar për tregti ndërkufitare të energjisë elektrike, kontrata furnizimi, marrëveshje të blerjes së energjisë, dhe çdo kontratë të nënshkruar në përputhje me marrëveshjet e blerjes së energjisë;
- d) raporti mbi statusin e pajisjeve kryesore dhe përlllogaritjen e vazhdimësisë së furnizimit;
- e) çdo kontratë të lidhur mbi sigurim sipas udhëzimeve të përcaktuara në liçencë.

Neni 29

Mbledhja dhe Dorëzimi i të Dhënave

29.1. ZRRE-ja kur të kërkojë informacione, të dhëna ose dokumente do t'i dërgojë të liçencuarit njoftim me shkrim ku specifikohet koha në të cilën duhet të dorëzohen informacionet, të dhënat ose dokumentet në ZRRE.

29.2. Sipas kërkesës së ZRRE-së, i liçencuari duhet të dorëzojë si vijon:

- a) informacione mbi çmimet e energjisë elektrike dhe ngrohjes, së bashku me informacionet mbi të ardhurat dhe shpenzimet e bëra në lidhje me vendosjen e çmimeve;

- b) informacione mbi kapacitetin e instaluar dhe të përdorshëm për prodhim të propozuar për blerje ose të blera nga ndërmarrja për energji për një periudhë të caktuar;
- c) të dhëna mbi sasi të prodhuar dhe/ose të shitura të energjisë elektrike dhe ngrohjes, si dhe shumat e paguara sipas kontratave të shitjes;
- d) informacione mbi punën e kryer sipas zbatimit të kontratave për shitje të energjisë elektrike dhe ngrohjes;
- e) informacione mbi standardet e përmbushjes së shërbimeve që i janë ofruar konsumatorëve, përfshirë kualitetin e shërbimeve, sigurinë dhe saktësinë e furnizimit;
- f) treguesit që matin vazhdimësinë e furnizimit (kohëzgjatjen, shpeshtësinë, numrin e ndërprerjeve dhe minutat e humbura për konsumatorët) si dhe shërbimet e sistemit (lidhjen në rrjet të konsumatorëve të rinj me kohë, riparimin e prishjeve të sistemit, mbajtjen e minutazhit sipas marrëveshjes për leximin e njehsorit, informacione të përgjithshme të matjes);
- g) kopjet e kontratave të sigurimit; dhe
- h) informacione të tjera që mund të kërkojë ZRRE-ja në lidhje me aktivitete që liçencohen.

Neni 30

Informacioni i Fshehtë dhe me Ndjeshmëri Komerciale

- 30.1. ZRRE-ja është e autorizuar të kërkojë informacione, të dhëna dhe dokumente sipas Nenit 29.2, pavarësisht nëse ky informacion, të dhënat dhe dokumentet përmbajnë informacione të fshehtë ose me ndjeshmëri komerciale.
- 30.2. Kur dorëzohen të dhënat dhe dokumentet e kërkuar, i liçencuari mund të identifikojë një informacion të siguar, ose mund të shënojë disa dokumente të dorëzuar, si të fshehtë dhe me ndjeshmëri komerciale, si dhe t'i kërkojë ZRRE-së që mos ta vërë këtë informacion në dispozicion të publikut.
- 30.3. ZRRE-ja do të vendosë nëse informacioni do të konsiderohet si i fshehtë dhe të mos vihet në dispozicion të publikut, në pajtim me Nenin 8 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2003/32 mbi Shpalljen e Ligjit mbi Qasjen në Dokumentet Zyrtare, në pajtim me Nenin 4 të Kodit të Sjelljes dhe Etikës, Rregullit mbi Fshehtësinë e Informacioneve miratuar nga Bordi i ZRRE-së, dhe çdo udhëzimi apo rregulloreje të aplikueshme.

Neni 31

Kriteret për të Liçencuarin në Lidhje me Ruajtjen dhe Mbledhjen e Informacioneve

ZRRE-ja mund t'i kërkojë të liçencuarit që të mbledhë dhe të mbajë informacionet, të dhënat dhe dokumentet që kanë të bëjnë me konsumatorët, pajisjet matëse, të dhënat në lidhje me matjet e cilësisë së furnizimit, dhe numrin e ankesave, përfshirë:

- a) emrat dhe adresat e konsumatorëve;
- b) vendndodhjen e pajisjeve matëse;

- c) të dhënat e shpërndarjes në lidhje me vlerësimet e bëra nga i licencuari;
- d) shumat e kompensimit që i janë paguar konsumatorit në rast të përmbushjes së dobët ,(nëse ka);
- e) numrin e kontratave të nënshkruara nga kategori të ndryshme konsumatorësh përfundimtarë;
- f) numrat dhe llojet e ankesave të regjistruara siç kërkohen nga ZRRE-ja;
- g) informacione të tjera shtesë nëse ZRRE-ja i sheh si të nevojshme;

Neni 32

Monitorimi i Aktiviteteve të Licencimit

- 32.1. Duke iu referuar kriterit për raportim dhe sigurim të informacioneve, siç paraqitet në Kapitullin 8 të këtij Rregulli, ZRRE-ja monitoron përmbushjen e aktiviteteve të licencuara bazuar në të dhënat që i licencuari ka dorëzuar.
- 32.2. I licencuari do të bashkëpunojë me ZRRE-në në sigurimin e të gjithë të dhënave të kërkuara gjatë periudhës së vlefshmërisë së licencës.
- 32.3. ZRRE-ja mund të kryejë inspektime fizike të stabilimenteve dhe dokumenteve që kanë të bëjnë me licencën, në zyrat (vizita periodike të njoftuara ose të pa njoftuara), ose t'i kërkojë Inspektoratit të Ministrisë së Energjisë dhe Minierave që të kryejë këtë mbikëqyrje sipas Nenit 32 të Ligjit mbi Energjinë dhe legjislacionit sekondar mbi Inspektoratin, nxjerrë nga Ministria e Energjisë dhe Minierave.

Neni 33

Standardet e Përmbushjes së Aktiviteteve

- 33.1. I licencuari do të kryejë aktivitetin për energji në përputhje me standardet e përmbushjes në sektorin e energjisë, siç është përcaktuar në kodet teknike dhe komerciale, Rregullin e Tregut dhe në rregulla tjerë të aprovuar nga ZRRE-ja.
- 33.2. Kontratat midis të licencuarit dhe konsumatorëve do të vihen në përputhje me dispozitat e Rregullit mbi Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji të miratuar nga ZRRE-ja, dhe cilësisë të shërbimeve ose standardeve të përmbushjes të vendosura nga ZRRE-ja.

Neni 34

Sigurimi

Termat dhe kushtet e licencës do të paraqesin detyrimet e sigurimit për çdo të licencuar.

KAPITULLI 9

MODIFIKIMI DHE PËRFUNDIMI I LICENCËS

Neni 35

Modifikimi nga ZRRE-ja

- 35.1. Liçencat mund të modifikohen me iniciativë të ZRRE-së vetëm në rrethanat vijuese:
- a) në mënyrë që të jenë në zbatim të kritereve të reja të përcaktuar nga marrëveshjet ndërkombëtare dhe ligjeve kombëtarë, rregulloreve dhe legjislacionit tjetër të aplikueshëm;
 - b) si një sanksion për shkeljen e termave dhe kushteve të liçencës, sipas Nenit 44;
 - c) nëse nevojitet për të mbrojtur sistemin energjetik në Kosovë.
- 35.2. Nëse modifikimi inicohet nga ZRRE-ja, i liçencuari do të njoftohet menjëherë me shkrim. Ky njoftim do të specifikojë bazat për modifikimin e propozuar dhe efektet që priten prej tij.
- 35.3. Brenda dy javësh prej datës së pranimit të njoftimit sipas Nenit 35.2, i liçencuari mund të dorëzojë një deklaratë me shkrim ku paraqiten pikëpamjet e tij në lidhje me bazat e paraqitura prej ZRRE-së për modifikimin e liçencës, dhe të bashkëngjisë çdo dokument mbështetës.

Neni 36

Aplikimi për Modifikim të Liçencës nga i Liçencuari

- 36.1. I Liçencuari mund të kërkojë modifikimin e liçencës së tij në çdo kohë. Forma e aplikimit për modifikim të liçencës përpilohet dhe publikohet nga ZRRE-ja.
- 36.2. Aplikanti do të dorëzojë të gjithë informacionet dhe dokumentet e nevojshme për të mbështetur këtë kërkesë për modifikim.
- 36.3. Modifikimi i një liçence i nënshtrohet vendimit të ZRRE-së.

Neni 37

Aplikimi për Shtyrje të Liçencës

- 37.1. Aplikimi për shtyrje të liçencës për aktivitetet e përfshirë në Nenin 28.2 të Ligjit mbi Rregullatorin e Energjisë, do të dorëzohet të paktën një (1) vit, por jo më shumë se tetëmbëdhjetë (18) muaj para skadimit të afatit fillestar, përveç për tregtimin e energjisë elektrike dhe ngrohjes dhe për transmetimin ndërkufitar (import, eksport, transit) të energjisë elektrike, ku në këtë rast aplikacioni do të dorëzohet të paktën gjashtë (6) muaj përpara skadimit të afatit fillestar.
- 37.2. Kohëzgjatja e çdo liçence mund të shtyhet për një periudhë që nuk e kalon afatin fillestar, me kusht që i liçencuari të plotësojë të gjithë detyrimet dhe kërkesat në liçencë, dhe të ketë dorëzuar një aplikacion me shkrim për shtyrjen brenda afatit përfundimtar të përcaktuar në Nenin 37.1.

- 37.3. Shtyrja do të datojë prej datës së skadimit të periudhës fillestare të vlefshmërisë së liçencës.

Neni 38

Mbyllja , Pezullimi ose Ndërprerja e një Stabilimenti të Liçencuar të Prodhimit

- 38.1. Para përfundimit të liçencës sipas Nenit 39, ZRRE-ja me iniciativën e vet ose me kërkesë të të liçencuarit, dhe në bashkëpunim me Ministrinë e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor dhe autoritete tjera relevante do të aprovojë:
- pezuillimin e prodhimit të energjisë elektrike dhe ngrohjes për një periudhë të shkurtër kohe;
 - ndërprerjen dhe dekomisionimin e prodhimit të energjisë dhe mbylljen e plotë të centralit të energjisë;
 - mbylljen e stabilimentit për energji, që i nënshtrohet kriterëve të kërimit të një garancie financiare e depozituar në bankë mjaftueshëm për të mbuluar shpenzimet.
 - nëse një stabiliment ekzistues për energji punon me 60 % të kapacitet të aprovuar për një periudhë prej pesë (5) viteve pa ndërprerje.
- 38.2. Duke u bazuar në Nenin 37, liçenca mund të vazhdohet nëse ky vazhdim nevojitet për të lehtësuar mbylljen, pezullimin ose ndërprerjen e aktivitetit të liçencuar.

Neni 39

Përfundimi i Liçencës

Çdo liçencë e lëshuar, mund të përfundohet në rastet vijuese:

- skadimi i periudhës së vlefshmërisë;
- me kërkesë të ndërmarrjes së liçencuar për energji;
- shpërbërja e personit ligjor që është bartës i liçencës;
- shkatërrimi i ndërmarrjes për energji;
- me anë të vendimit të një gjykate, ku deklarohet paaftësia paguese e të liçencuarit, ose vendimi i gjykatës për të përfunduar aktivitetin për energji për shkak të deklaratës së të liçencuarit për likuidim;
- nëse aktiviteti i liçencuar për energji nuk është kryer për më shumë se gjashtë (6) muaj, përveç nëse pezullimi i aktivitetit është kryer me aprovim të ZRRE-së;
- nëse janë plotësuar dispozitat e Nenit 38; dhe
- si ndëshkim nga ana e ZRRE-së sipas Nenit 44 të këtij Rregulli.

KAPITULLI 10

TRANSFERIMI I LIÇENCËS DHE TJETËRSIMI I ASETËVE TË TË LIÇENCUARIT

Neni 40

Mbrojtja e Sistemit Energjetik

Të gjithë vendimet në lidhje me lëshimin, modifikimin, tërheqjen ose përfundimin e një liçence, do të merren vetëm nëse masat e duhur mbrojtëse për sistemin energjetik mund të sigurohen për të mbështetur këto vendime.

Neni 41

Transferimi i Liçencës

- 41.1. Nëse i Liçencuari kërkon të transferojë liçencën në një entitet tjetër, ai është i detyruar të marrë aprovimin paraprak të ZRRE-së për këtë transferim. Deri sa të merret ky aprovim, i Liçencuari aktual është i detyruar të vazhdojë kryerjen e detyrimeve sipas liçencës së vet, deri sa ZRRE-ja të aprovojë transferimin.
- 41.2. Transferimi i liçencës mund të aprovohet nga ZRRE-ja vetëm në rast se arsyet për këtë transferim të jenë të justifikuar nga aplikanti dhe:
 - a) transferuesi i propozuar do të pranojë dhe shkarkojë detyrimet e mbetura të të Liçencuarit aktual, qoftë sipas kësaj Liçence, këtij Rregulli, ose edhe sipas legjislacionit tjetër të aplikueshëm;
 - b) transferuesi i propozuar do të plotësojë të gjithë kushtet e paraqitur në këtë Rregull mbi Liçencat, dhe legjislacionit tjetër të aplikueshëm.
- 41.3. I Liçencuari i ri duhet të marrë liçencën ose aprovimin për transferimin nga ZRRE-ja, përpara fillimit të aktiviteteve.
- 41.4. Mënyra e transferimit kryhet ashtu siç përdoret për dhënien e liçencës. ZRRE-ja do të përcaktojë nëse i transferuari është i aftë për të përmbushur kushtet e liçencës. Kohëzgjatja e vlefshmërisë së liçencës, dhe përmbajtja e liçencës do të mbetet e njëjtë.
- 41.5. Forma e aplikimit nga i Liçencuari për transferim do të përgatitet dhe publikohet nga ZRRE-ja.

Neni 42

Tjetërsimi i Aseteve të Liçencuara

- 42.1. Tjetërsimi i pronës materiale ose asetëve që është përdorur nga i liçencuari për kryerjen e aktivitetit të liçencuar, do t'i nënshtrohet aprovimit të ZRRE-së.
- 42.2. Termat dhe kushtet e liçencave do të përfshijnë dispozitat në lidhje me aprovimet që kërkohen për tjetërsimin e pronës materiale ose asetëve në fjalë.

KAPITULLI 11

PËRJASHTIMI

Neni 43 Përjashtimi

- 43.1. Asnjë liçence nuk do të kërkohet për:
- a) prodhimin e energjisë elektrike prej centraleve të energjisë me kapacitet që nuk e kalojnë 5 MW;
 - b) prodhimin e ngrohjes prej ngrohësve me kapacitet që nuk e kalojnë 1 MW;
 - c) prodhimin e energjisë elektrike ose ngrohjes për vetë-konsum.
- 43.2. Prodhimi i energjisë elektrike dhe ngrohjes për vetë-konsum do të thotë prodhim nga një entitet ligjor ku shfrytëzuesi i fundit është i njëjti entitet ligjor si prodhuesi, dhe kërkesa e shfrytëzuesit të fundit për energji, është së paku 75 % të matura bashkë si energjisë totale të prodhuar/konsumuar gjatë secilit vit kalendarik nga data e shfrytëzimit komercial të njësisë prodhuese dhe energjisë (ngarkesa maksimale/ kapaciteti nominal i centralit). Në fund të çdo viti kalendarik ZRRE-ja do të monitoroj energjinë e prodhuar/konsumuar dhe nëse përqindja është tejkaluar për arsye të ndryshme, atëherë do të nevojitet liçenca për prodhim.

KAPITULLI 12

NDËSHKIMET DHE ANKESAT

Neni 44 Ndëshkimet e Vendosura nga ZRRE-ja

- 44.1. Nëse ndërmarrja për energji dështon që ti përmbush kriteret e paraqitur në këtë Rregull, kjo do të përbëjë një shkelje dhe mund ti caktohen gjobat të liçencuarit nga ZRRE-ja, në përputhje me Nenin 57 të Ligjit mbi Rregullatorin e Energjisë.
- 44.2. Shuma e gjobave do të përllogaritet në bazë të Nenit 57.2 të Ligjit mbi Rregullatorin e Energjisë, Rregullit mbi Masat Administrative dhe Gjobat dhe me Rregullat tjera të lëshuara nga ZRRE-ja.
- 44.3. Përpara vendosjes së një gjobe, ZRRE-ja do të njoftojë ndërmarrjen për energji mbi shkeljen dhe do t'i sigurojë mundësinë për t'u përgjigjur me shkrim, brenda katërmëdhjetë (14) ditësh prej njoftimit.
- 44.4. Nëse gjoba e vendosur prej ZRRE-së nuk paguhet menjëherë ose sipas një plani të pranueshëm nga ZRRE-ja, kjo e fundit do të fillojë procedura gjyqësore për mbledhjen e gjobave si borxh civil.
- 44.5. ZRRE-ja mund të fillojë një procedurë për tërheqjen e liçencës së lëshuar. Tërheqja e një liçence është një sanksion serioz dhe shqiptohet vetëm pasi të liçencuarit i është dhënë

mundësia për të korigjuar shkeljet, dhe kur gjobat nuk kanë qenë efektive ose mendohet se nuk kanë qenë të mjaftueshme. Varësisht nga këto kufizime tërheqja lejohet në shembujt vijues:

- a) i liçencuari nuk plotëson ose shkel kushtet materiale ose detyrimet në liçencë, dhe këto lëshime ose shkelje nuk janë ndrequr brenda afatit përfundimtar të dhënë nga ZRRE-ja, ose kanë dëmtuar seriozisht cilësinë, sigurinë dhe besueshmërinë e shërbimeve që i liçencuari shpërdorues ka qenë i detyruar të plotësojë;
 - b) monitorimi i liçencave prej ZRRE-së ose nëse Inspektorati i Ministrisë të Energjisë dhe Minierave, ka konstatuar dështim në plotësimin e kriterëve administrative dhe ky dështim nuk është përmirësuar brenda afatit të dhënë nga ZRRE-ja;
 - c) i liçencuari ka paraqitur informacione materialisht false në bazë të të cilave është dhënë liçenca.
- 44.6. Kur tërheqja e një liçence prek sigurinë dhe besueshmërinë e furnizimit me energji, ZRRE-ja do të caktojë një të liçencuar tjetër për të siguruar furnizimin dhe për të operuar me asetet që i përkasin liçencës që iu nënshtroa tërheqjes.

Neni 45

Ankimi ndaj Vendimi të ZRRE-së

- 45.1 Çdo vendim me interes publik i marrë nga ZRRE-ja, do të botohet në mënyrë të shpejtë në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së dhe në buletin e saj.
- 45.2 Vendimet e ZRRE-së, përfshirë refuzimet, mund t'i nënshtrohen ankimit në një gjykatë të juridiksionit kompetent, brenda katërmëdhjetë (14) ditëve prej datës në të cilën vendimi është aprovuar dhe publikuar në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

KAPITULLI 13

DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 46

Ndryshimi i Rregullit

- 46.1. Çdo propozim për ndryshim të këtij Rregulli, do t'i dërgohet ZRRE-së me shkrim ose do të iniciohet nga vetë ZRRE-ja.
- 46.2. Ndryshimi do të bëhet me vendim të Bordit të ZRRE, vetëm nëse është e nevojshme për të shpënë më tutje objektivat e ZRRE-së nëse është në interes të përgjithshëm.
- 46.3. Vendimi do të botohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së, dhe kurdo që është e mundshme, në gazeta ditore, televizion dhe radio, tridhjetë (30) ditë përpara hyrjes në fuqi.

Neni 47
Gjuha Zyrtare e Rregullit

Ky Rregull është nxjerrë në shqip, serbisht dhe anglisht. Në rast të mosmarrëveshjeve në lidhje me termat, dhe në rast se kjo mosmarrëveshje rrjedh prej përkthimeve të ndryshme të këtij Rregulli, do të merret si bazë versioni anglisht.

Neni 48
Hyrja në Fuqi dhe Aplikueshmëria

- 48.1. Ky Rregull do të hyjë në fuqi tridhjetë (30) ditë pas botimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së.
- 48.2. Dispozitat e këtij Rregulli do të aplikohen për të gjitha ndërmarrjet për energji në Kosovë.

Neni 49
Dispozitat Kalimtare

- 49.1. Të gjitha ndërmarrjet për energji që janë funksionuese gjatë kohës së miratimit të këtij Rregulli, do të aplikojë për liçencën brenda nëntëdhjetë (90) ditësh prej afatit të cekur në nenin 48.1 të këtij Rregulli.
- 49.2. Në rast se ndërmarrja për energji nuk përmbush disa kritere për marrjen e liçencës siç paraqitet në këtë Rregull, si dhe nëse është e arsyeshme që të besohet se brenda një periudhe të caktuar kohe aplikuesi mund të përmbushë këto kritere, ZRRE-ja mund të lëshojë Liçencën me Kushte, në përputhje me Nenin 33 të Ligjit mbi Rregullatorin e Energjisë.
- 49.3. Në liçencën me kushte e nxjerrë sipas Nenit 49.2, ZRRE-ja do të paraqet një plan me anë të të cilit, të gjithë të liçencuarit do t'i sigurojnë ZRRE-së të gjithë dokumentet e nevojshëm dhe kriteret për zbatimin, të paraqitur në këtë Rregull.

Kryesuesi i Bordit të ZRRE-së

Anëtarët e Bordit të ZRRE-së
